



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.22

2006

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.9484 datë 2.3.2006	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në amendamentin e Londrës, aneksi II, të protokollit të Montrealit “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit”..... 679
Ligj nr.9485 datë 6.3.2006	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në amendamentin e Montrealit të protokollit të Montrealit “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit”..... 690
Ligj nr.9486 datë 6.3.2006	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në amendamentin e Pekinit të protokollit të Montrealit “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit”..... 692
Vendim i Kuvendit nr.23, datë 13.3.2006	Për një ndryshim në vendimin nr.88, datë 8.9.2003 “Për miratimin e numrit të punonjësve të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive”, ndryshuar me vendimin nr.189, datë 19.5.2005 të Kuvendit..... 695
Dekret nr.4810 datë 21.3.2006	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare..... 696
Dekret nr.4811 datë 21.3.2006	Për lirim ambasadori..... 697
	Vendim i shkurtuar për shpalljen të zhdukur të shtetasit Demir Biduli..... 697
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasve Leje Zyberaj dhe Flutura Zyberaj..... 697

Ndreqje gabimi për Fletoren 9 dhe 15 të vitit 2006.....	698
---	-----

L I G J
Nr.9484, datë 2.3.2006

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË AMENDAMENTIN E LONDRËS,
ANEKSI II, TË PROTOKOLLIT TË MONTREALIT “PËR SUBSTANCAT QË HOLLOJNË
SHTRESËN E OZONIT”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 shkronja “b” të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në amendamentin e Londrës, Aneksi II, të Protokollit të Montrealit “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekreten nr.4807, datë 20.3.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Alfred Moisiu**

AMENDAMENTI I PROTOKOLLIT
TË MONTREALIT PËR SUBSTANCAT QË HOLLOJNË SHTESËN E OZONIT
MIRATUAR NGA TAKIMI I NËNTË I PALËVE

Neni 1

Amendamenti

A. Neni 4, paragrafi 1 qua

Paragrafi i mëposhtëm do të futet pas paragrafit 1 ter të nenit 4 të protokollit:

1 qua. Brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij paragrafi, çdo palë do të ndalojë importin e substancës së kontrolluar në aneksin E nga shtete që nuk janë palë të këtij protokollit.

B. Neni 4, paragrafi 2 qua

Paragrafi i mëposhtëm do të futet pas paragrafit 2 ter të nenit 4 të protokollit:

2 qua. Duke filluar nga një vit pas datës së hyrjes në fuqi të këtij paragrafi, çdo palë do të ndalojë eksportin e substancës së kontrolluar në aneksin E në çdo shtet që nuk është palë e këtij protokollit

C. Neni 4, paragrafët 5, 6 dhe 7

Në paragrafët 5, 6 dhe 7 të nenit 4 të protokollit, për fjalët:

dhe grupi II i aneksit C

Atje do të zëvendësohen:

Grupi II të aneksit C dhe aneksin E

D. Neni 4, paragrafi 8

Në paragrafin 8 të nenit 4 të protokollit, për fjalët:

Neni 2G
do të zëvendësohen me:
Nenet 2G dhe 2H

E. Neni 4A: Kontrolli i tregtisë me palët

Neni i mëposhtëm do t'i shtohet protokollit si neni 4A:

1. Në rastet, kur pas kalimit të datës së aplikueshme për një substancë të kontrolluar, një palë nuk është në gjendje, megjithëse ka marrë të gjitha hapat praktike për të përmbushur me detyrimet e protokollit, të ndalojë prodhimin e kësaj substance për konsum vendas, me përjashtim të përdorimeve të tjera të rëna dakord nga palët që janë thelbësore, ajo do ta ndalojë eksportin e sasive të përdorura, ricikluara dhe rikuperuara të kësaj substance, për qëllime të tjera përveç shkatërrimit.

2. Paragrafi 1 i këtij neni do të aplikohet pa paragjykim për veprimin e nenit 11 të Konventës dhe procedurat e moszbatimit zhvilluar nën nenin 8 të këtij protokoll.

F. Neni 4B: Licencimi

Neni i mëposhtëm do t'i shtohet protokollit si neni 4B:

1. Çdo palë që nga 1 janari 2000 ose brenda tre muajve që nga data e hyrjes në fuqi e këtij neni, cilado nga këto data që është më e vonshme, do të vendosë dhe zbatojë një sistem për licencimin e importit dhe eksportit të substancave të reja, ricikluara ose rikuperuara në anekset A, B, C dhe E.

2. Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, çdo palë që vepron nën paragrafin 1 të nenit 5, e cila vendos që nuk është në gjendje të vendosë dhe të zbatojë një sistem për licencimin e importit dhe eksportit të substancave të kontrolluara në anekset C dhe E, mund ta shtyjë marrjen e këtyre vendimeve, respektivisht deri në 1 janar 2005 dhe 1 janar 2002.

3. Çdo palë, brenda tre muajve nga data e futjes së sistemit të licencimit, do t'i raportojë sekretariatit mbi vendosjen e këtij sistemi.

4. Sekretariati periodikisht do të përgatisë dhe qarkullojë në të gjitha palët, një listë të të gjitha palëve që kanë raportuar për sistemin e licencimit dhe do t'ia kalojë këtë informacion Komitetit të Implementimit për vlerësim dhe rekomandime për palët.

Neni 2

Lidhja me amendamentin e vitit 1992

Asnjë shtet ose organizatë për integrimin ekonomik rajonal nuk mund të depozitojë një instrument ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi me këtë amendament në rast se, më parë ose në të njëjtën kohë, nuk ka depozituar një instrument të tillë për amendamentin e miratuar në takimin e katërt të palëve në Kopenhagen më 25 nëntor 1992.

Neni 3

Hyrja në fuqi

1. Ky amendament do të hyjë në fuqi më 1 janar 1999, në rast se të paktën njëzet instrumente ratifikimi, pranimi ose miratimi të këtij amendamenti janë depozituar nga shtetet ose organizatat ekonomike për integrim rajonal që janë palë të protokollit të Montrealit për substancat që hollojnë shtresën e ozonit. Në rast se ky kusht nuk është përmbushur deri në atë datë, amendamenti do të hyjë në fuqi në ditën e nëntëdhjetë pas datës në të cilën është plotësuar.

2. Për qëllime të paragrafit 1, çdo instrument i tillë i depozituar nga një organizatë rajonale për integrim ekonomik nuk do të konsiderohet si shtesë e atyre të depozituara nga shtetet anëtare të këtyre organizatave.

3. Pas hyrjes në fuqi të këtij amendamenti, siç jepet në paragrafin 1, ai hyn në fuqi për të gjitha palët e tjera të protokollit në ditën e nëntëdhjetë të depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimi ose miratimit.

ANEKSI II
AMENDAMENTI I PROTOKOLLIT TË MONTREALIT PËR SUBSTANCAT
QË HOLLOJNË SHITESËN E OZONIT

Neni 1
Amendament

A. Paragrafët preambularë

1. Paragrafi i 6-të preambular i protokollit do të zëvendësohet me paragrafin e mëposhtëm:

Të vendosur për të mbrojtur shtresën e ozonit, duke marrë masa parandaluese për të kontrolluar shkarkimet globale të justifikueshme të substancave që e hollojnë atë, me objektivin përfundimtar të eliminimit të tyre mbi bazat e zhvillimeve të njohurive shkencore, duke marrë parasysh faktorët teknikë dhe ekonomikë dhe duke mbajtur në mend nevojat për zhvillim të vendeve në zhvillim,

2. Paragrafi i 7-të preambular i protokollit do të zëvendësohet me paragrafin e mëposhtëm:

Duke njohur që kushte të caktuara nevojiten për të përballuar nevojat e vendeve në zhvillim, duke përfshirë nevojat për resurse financiare shtesë dhe akses në teknologjitë relevante, duke mbajtur në mend se shkalla e fondeve që nevojiten është e parashikueshme, dhe se fondet mund të pritet të bëjnë një ndryshim thelbësor në mundësitë e botës për t'u marrë me problemin e njohur shkencërisht të hollimit të ozonit dhe efektet e tij të dëmshme,

3. Paragrafi i 9-të preambular i protokollit do të zëvendësohet me paragrafin e mëposhtëm:

Duke konsideruar rëndësinë e promovimit të bashkëpunimit ndërkombëtar në kërkimet, zhvillimin dhe transferimin e teknologjive alternative përsa i përket kontrollit dhe uljes së shkarkimeve që hollojnë shtresën e ozonit, duke mbajtur në mend veçanërisht nevojat e vendeve në zhvillim.

B. Neni 1

Përkufizime

1. Paragrafi 4 i nenit 1 të protokollit do të zëvendësohet me paragrafin e mëposhtëm:

4. “Substanca të kontrolluara” do të thotë një substancë në aneksin A ose në aneksin B të këtij protokollit, që ekzistojnë veçmas ose në përzierje. Ajo përfshin izomeret e çdo substance të tillë, përveç rasteve të specifikuara në anekset përkatëse, por përjashton çdo substancë të kontrolluar ose përzierje në një produkt të prodhuar, me përjashtim të kontenierëve që përdoren për transportin dhe ruajtjen e asaj substance.

2. Paragrafi 5 i nenit 1 të protokollit do të zëvendësohet me paragrafin e mëposhtëm:

5. “Prodhim” do të thotë sasia e substancave të kontrolluara të prodhuara, minus sasinë e shkatërruar nga teknologjia që do të aprovohet nga palët dhe minus sasinë që përdoret tërësisht si lëndë në prodhimin e kimikateve të tjera. Sasia e ricikluar dhe e ripërdorur nuk konsiderohet si “prodhim”.

3. Paragrafi i mëposhtëm do t'i shtohet nenit 1 të protokollit:

9. “Substanca transitore” do të kuptohet një substancë në aneksin C të këtij protokollit, që ekziston vetëm ose në një përzierje. Ajo përfshin izomeret e çdo substance të tillë, me përjashtim të rasteve kur mund të specifikohet në aneksin C, por përfshin çdo substancë transitore ose përzierje që ndodhet në një produkt të prodhuar me përjashtim të kontenierëve që përdoren për transport ose ruajtje të asaj substance.

C. Neni 2, paragrafi 5

Paragrafi 5 i nenit 2 të protokollit do të zëvendësohet me paragrafin e mëposhtëm:

5. Çdo palë, për çdonjërin ose për më shumë periudha kontrolli, mundet t'i transferojë një pale tjetër çdo pjesë të nivelit të llogaritur të prodhimit të treguar në nenet 2A deri në 2E, në rastet kur totali i kombinuar i niveleve të prodhimit të palëve të interesuara për substancat e kontrolluara nuk e kalon kufirin e prodhimit të caktuar në këto nene për atë grup. Transferta të tilla të prodhimit do t'i njoftohen sekretariatit nga secila nga palët e interesuara, duke deklaruar termat e transfertave të tilla

dhe periudhën për të cilën aplikohen.

D. Neni 2, paragrafi 6

Fjalët e mëposhtme do të futen në paragrafin 6 të nenit 2 para fjalëve “substancave të kontrolluara” herën e parë që ato shfaqen:

Aneksi A ose aneksi B

E. Neni 2, paragrafi 8 (a)

Fjalët e mëposhtme do të shtohen para fjalëve “ky nen” kudo që ato paraqiten në paragrafin 8 (a) të nenit 2 të protokollit:

dhe nenet 2A deri 2E

F. Neni 2, paragrafi 9 (a) (i)

Fjalët e mëposhtme do të shtohen pas “Aneksi A” në paragrafin 9 (a) (i) të nenit 2 të protokollit:

dhe/ose aneksi B

G. Neni 2, paragrafi 9 (a) (ii)

Fjalët e mëposhtme do të fshihen nga paragrafi 9 (a) (ii) i nenit 2 të protokollit: nga 1986 nivelet

H. Neni 2, paragrafi 9 (c)

Fjalët e mëposhtme do të fshihen nga paragrafi 9 i nenit 2 të protokollit: që përfaqësojnë të paktën pesëdhjetë për qind të konsumit total të substancave të kontrolluara të palëve dhe do të zëvendësohen nga që përfaqësojnë një shumicë të palëve që veprojnë nën paragrafin 1 të nenit 5 që janë prezente dhe votojnë dhe një shumicë e palëve që nuk veprojnë kështu që janë prezente dhe votojnë.

I. Neni 2, paragrafi 10 (b)

Paragrafi 10 (b) i nenit 2 të protokollit do të fshihet, dhe paragrafi 10 (a) i nenit 2 do të bëhet paragrafi 10.

J. Neni 2, paragrafi 11

Fjalët e mëposhtme do të shtohen pas fjalëve “ky nen” kudo që ato paraqiten në paragrafin 11 të nenit 2 të protokollit:

dhe nenet 2A deri 2E

K. Neni 2C: CFC të tjera të halogjenizuara plotësisht

Paragrafët e mëposhtëm do t’i shtohen protokollit si neni 2C:

Neni 2C: CFC të tjera të halogjenizuara plotësisht

1. Çdo palë do të sigurojë që për periudhën dymbëdhjetë mujore, duke filluar që nga 1 janari 1993, dhe në çdo periudhë 12-mujore të mëpasme, niveli i llogaritur i konsumit të substancave të kontrolluara të grupit I të aneksit B nuk do të kalojë, në vit, tetëdhjetë për qind të nivelit të llogaritur të konsumit në vitin 1989. Çdo palë që prodhon një ose më shumë nga këto substanca, për të njëjtën periudhë do të sigurojë që niveli i llogaritur i prodhimit të substancave nuk do të kalojë tetëdhjetë për qind, të nivelit të llogaritur të prodhimit në vitin 1989. Megjithatë, për të kënaqur nevojat bazë brenda vendit të palëve që veprojnë sipas paragrafit 1/neni 5, niveli i llogaritur i prodhimit mund ta kalojë atë limit me deri në 10 për qind të nivelit të llogaritur të prodhimit në vitin 1989.

2. Çdo palë do të sigurojë që për periudhën dymbëdhjetë mujore, duke filluar nga 1 janari 1997, dhe në çdo periudhë dymbëdhjetë mujore të mëpasme, niveli i llogaritur i konsumit të substancave të kontrolluara në grupin I të aneksit B nuk e kalon, në vit, pesëmbëdhjetë për qind të nivelit të konsumit të llogaritur në vitin 1989. Çdo palë që prodhon një ose më shumë prej këtyre substancave do të sigurojë që, për të njëjtën periudhë, niveli i llogaritur i prodhimit të substancave, në vit nuk do të kalojë pesëmbëdhjetë për qind të prodhimit të llogaritur në vitin 1989. Megjithatë, në mënyrë që të kënaqen nevojat e brendshme të palëve që veprojnë sipas nenit 5, niveli i llogaritur i

prodhimit mund ta kalojë këtë limit me deri në dhjetë për qind të nivelit të prodhimit të llogaritur në vitin 1989.

3. Çdo palë do të sigurohet që për periudhën dymbëdhjetëmujore, duke filluar nga 1 janari 2000, dhe në çdo periudhë dymbëdhjetëmujore pasardhëse, niveli i konsumit të substancave të kontrolluara në grupin I aneksi B nuk e kalon zeron. Çdo palë që prodhon një ose më shumë prej këtyre substancave, për të njëjtat periudha do të sigurohet që niveli i përlllogaritur i prodhimit nuk e kalon zeron. Megjithatë, në mënyrë që të kënaqen nevojat e palëve që veprojnë nën paragrafin 1 të nenit 5, niveli i llogaritur i prodhimit mund ta kalojë këtë limit me deri në pesëmbëdhjetë për qind të nivelit të llogaritur në vitin 1989.

L. Neni 2D: Karboni tetraklorid

Paragrafët e mëposhtëm do t'i shtohen protokollit si neni 2D:

Neni 2D: Karboni tetraklorid

1. Çdo palë do të sigurojë që për periudhën dymbëdhjetëmujore, duke filluar nga 1 janari 1995, dhe në çdo periudhë të mëpasme dymbëdhjetëmujore, niveli i llogaritur i konsumit të substancave të kontrolluara në grupin II të aneksit B, nuk e kalon, në vit, pesëmbëdhjetë për qind të nivelit të konsumit të llogaritur në vitin 1989. Çdo palë që e prodhon substancën, për të njëjtat periudha do të sigurojë që niveli i llogaritur i prodhimit të substancës nuk do të kalojë, në vit, pesëmbëdhjetë për qind të nivelit të llogaritur të prodhimit në vitin 1989. Megjithatë, në mënyrë që të kënaqin nevojat e brendshme vendet që veprojnë nën paragrafin 1 të nenit 5, niveli i llogaritur i prodhimit mund ta kalojë këtë limit me deri në dhjetë për qind të prodhimit në vitin 1989.

2. Çdo palë do të sigurojë që për periudhën dymbëdhjetëmujore, duke filluar nga 1 janari 2000, dhe në çdo periudhë dymbëdhjetëmujore të mëpasme, niveli i llogaritur i konsumit të substancës së kontrolluar në grupin II të aneksit B nuk e kalon zeron. Çdo palë që prodhon substancën, për të njëjtat periudha do të sigurojë që niveli i llogaritur i prodhimit të substancës nuk e kalon zeron. Megjithatë, në mënyrë që të kënaqen nevojat e brendshme të palëve që veprojnë nën paragrafin 1 të nenit 5, niveli i prodhimit të llogaritur mund të kalojë këtë limit me deri në dhjetë për qind të prodhimit të vitit 1989.

M. Neni 2E: 1, 1, 1 trikloretani (metili i kloroformit)

Paragrafët e mëposhtëm do të shtohen në protokoll si neni 2E:

Neni 2E: 1, 1, 1 trikloretani (metili i kloroformit)

1. Çdo palë do të sigurojë që për periudhën dymbëdhjetëmujore duke filluar në 1 janar 1993, dhe për çdo periudhë dymbëdhjetëmujore të mëpasme, niveli i llogaritur i konsumit të substancës së kontrolluar në grupin III të aneksit B nuk e kalon, në vit, nivelin e llogaritur të konsumit në vitin 1989. Çdo palë që e prodhon substancën, për të njëjtat periudha do të sigurojë që niveli i llogaritur i prodhimit të substancës nuk do ta kalojë, nivelin e llogaritur të prodhimit në vitin 1989. Megjithatë, në mënyrë që të kënaqen nevojat e brendshme të palëve që veprojnë nën paragrafin 1 të nenit 5, niveli i llogaritur mund ta kalojë këtë limit me deri në dhjetë për qind të nivelit të llogaritur të prodhimit në vitin 1989.

2. Çdo palë do të sigurojë që për periudhën dymbëdhjetëmujore, duke filluar nga 1 janari 1995, dhe në çdo periudhë dymbëdhjetëmujore të mëpasme, niveli i llogaritur i konsumit të substancës së kontrolluar në grupin III të aneksit B nuk i kalon, në vit, shtatëdhjetë për qind të nivelit të konsumit të llogaritur në vitin 1989. Çdo palë që prodhon substancën, për të njëjtën periudhë do të sigurojë që niveli i llogaritur i prodhimit të substancës nuk do të kalojë, në vit, shtatëdhjetë për qind të nivelit të llogaritur të konsumit në vitin 1989. Megjithatë, në mënyrë që të kënaqen nevojat bazë të brendshme të palëve që veprojnë nën paragrafin 1 të nenit 5, niveli i llogaritur i prodhimit mund ta kalojë këtë limit me deri në dhjetë për qind të nivelit të llogaritur të prodhimit në vitin 1989.

3. Çdo palë do të sigurojë që për periudhën dymbëdhjetëmujore, duke filluar nga 1 janari 2000, dhe në çdo periudhë dymbëdhjetëmujore pasuese, niveli i llogaritur i konsumit të substancës së kontrolluar në grupin III të aneksit B nuk e kalon, në vit, tridhjetë për qind të nivelit të llogaritur të konsumit të vitit 1989.

Çdo palë që prodhon substancën, për të njëjtën periudhë do të sigurojë që niveli i prodhimit të substancës nuk e kalon, në vit, tridhjetë për qind të nivelit të llogaritur të prodhimit të viti 1989. Megjithatë, për të kënaqur nevojat bazë të brendshme të palëve që veprojnë nën paragrafin 1 të nenit

5, niveli i llogaritur i prodhimit mund ta kalojë këtë limit me deri dhjetë për qind të nivelit të llogaritur të prodhimit të vitit 1989.

4. Çdo palë do të sigurojë që për periudhën dymbëdhjetë mujore, duke filluar nga 1 janari 2005, dhe për çdo periudhë dymbëdhjetë mujore pasuese, niveli i konsumit të llogaritur të substancës së kontrolluar në grupin III të aneksit B nuk e kalon zeron. Çdo palë që e prodhon substancën, për të njëjtat periudha duhet të sigurojë që niveli i llogaritur i prodhimit të substancës nuk e kalon zeron. Megjithatë, në mënyrë që të kënaqen nevojat bazë të brendshme të palëve që veprojnë nën paragrafin 1 të nenit 5, niveli i llogaritur i prodhimit mund ta kalojë këtë limit me deri pesëmbëdhjetë për qind të nivelit të llogaritur të prodhimit të vitit 1989.

5. Palët do të rishikojnë në vitin 1992, mundësinë e një axhende më të shpejtë për uljet sesa të parashikuara në këtë nen.

N. Neni 3: Llogaritja e niveleve të kontrollit

Fjalët e mëposhtme do të shtohen pas “Nenet 2” në nenin 3 të protokollit:

2A deri 2E,

2. Fjalët e mëposhtme do të shtohen pas “Aneksi A” çdo herë që ato paraqiten në nenin 3 të protokollit:

ose aneksi B

O. Neni 4: Kontrolli i tregtisë me jo palët

1. Paragrafët 1 deri 5 të nenit 4 do të zëvendësohen me paragrafët e mëposhtëm:

1. Që nga 1 janari 1990, çdo palë do të ndalojë importin e substancave, të kontrolluara në aneksin A nga çdo shtet që nuk është palë në këtë protokoll.

1 bis. Brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij paragrafi, çdo palë do të ndalojë importin e substancave të kontrolluara në aneksin B nga çdo shtet që nuk është palë në këtë protokoll.

2. Që nga 1 janari 1993, çdo palë do të ndalojë eksportin e çdo substance të kontrolluar në aneksin A në çdo shtet që nuk është palë në këtë protokoll.

2 bis. Duke filluar një vit pas ditës së hyrjes në fuqi të këtij paragrafi, çdo palë do të ndalojë eksportin e çdo substance të kontrolluar në aneksin B në çdo shtet që nuk është palë në këtë protokoll.

3. Nga 1 janari 1992, palët, duke ndjekur procedurat në nenin 10 të Konventës, do të sqarojnë në një listë aneks produktet që përmbajnë substancat e kontrolluara në aneksin A. Palët që nuk kanë pasur kundërshtime për aneksin, në përputhje me procedurat, do të ndalojnë, brenda një viti të hyrjes në fuqi të aneksit, importin e atyre produkteve nga çdo shtet që nuk është palë në këtë protokoll.

3 bis. Brenda tre viteve nga data e hyrjes në fuqi të këtij paragrafi, palët, duke ndjekur procedurat e nenit 10 të Konventës, do të sqarojnë në një aneks një listë të produkteve që përmbajnë substancat e kontrolluara në aneksin B. Palët që nuk kanë pasur kundërshtime për aneksin në përputhje me ato procedura, do të ndalojnë, brenda një viti të hyrjes në fuqi të aneksit, importin e këtyre produkteve nga çdo shtet që nuk është palë në këtë protokoll.

4. Nga 1 janari 1994, palët do të vendosin mundësinë e ndalimit ose kufizimit, nga shtetet që nuk janë palë të këtij protokoll, importin e produkteve të prodhuara me, por që nuk përmbajnë, substancat e kontrolluara në aneksin A. Në rast se është e mundur, palët, duke ndjekur procedurat e nenit 10 të Konventës, do të sqarojnë në një aneks një listë të këtyre produkteve. Palët që nuk kanë kundërshtuar aneksin do të ndalojnë në përputhje me aneksin, brenda vitit të futjes në fuqi të aneksit, importin e këtyre produkteve nga shtetet që nuk janë palë të këtij protokoll.

4 bis. Brenda pesë viteve nga data e hyrjes në fuqi të këtij paragrafi, palët do të vendosin mundësinë e ndalimit ose kufizimit nga shtetet që nuk janë anëtare të këtij protokoll, të importit të produkteve të prodhuara, por që nuk përmbajnë substanca të kontrolluara në aneksin B. Në qoftë se është e mundur, palët, duke ndjekur procedurat e nenit 10 të Konventës, do të sqarojnë në një aneks një listë të këtyre produkteve. Palët që nuk kanë pasur kundërshtime për aneksin do të ndalojnë ose kufizojnë, brenda vitit të hyrjes në fuqi të aneksit, importin e këtyre produkteve nga çdo shtet që nuk është palë në këtë protokoll.

5. Çdo palë merr përsipër brenda mundësive praktike të mundshme, të dekurajojë eksportin në çdo shtet, që nuk është palë e këtij protokoll, të teknologjisë për prodhimin dhe përdorimin e

substancave të kontrolluara.

2. Paragrafi 8 i nenit 4 të protokollit do të zëvendësohet me paragrafin e mëposhtëm:

8. Moszbatimi i dispozitave të këtij neni, importet e referuara në paragrafët 1, 1 bis, 3, 3 bis, 4 dhe 4 bis dhe eksportet e referuara në paragrafët 2 dhe 2 bis, mund të lejohen nga, ose në çdo shtet që nuk është palë e këtij protokollit, në qoftë se vendoset nga një mbledhje e palëve që ai shtet është në përputhje të plotë me nenin 2, nenet 2A deri 2E, dhe këtë nen dhe ka dorëzuar të dhëna për këtë fakt, siç specifikohet në nenin 7.

3. Paragrafi i mëposhtëm do të shtohet në nenin 4 të protokollit si paragrafi 9:

9. Për qëllimet e këtij neni, termi “Shtet që nuk është palë i këtij protokollit” do të përfshijë, përta i përket një substance specifike të kontrolluar, një shtet ose organizatë rajonale të integritetit ekonomik që nuk ka rënë dakord që të zbatojë masat e kontrollit në fuqi për atë substancë.

P. Neni 5: Situata e veçantë e vendeve të zhvillim

Neni 5 i protokollit do të zëvendësohet si më poshtë:

1. Çdo palë që është një vend në zhvillim dhe niveli i llogaritur i konsumit të substancave në aneksin A është më pak se 0.3 kilogramë për frymë në datën e hyrjes në fuqi të protokollit për atë, ose çdo kohë pas deri në 1 janar 1999, në mënyrë që të përmbushë kërkesat bazë të brendshme, do të ketë të drejtë të vonojë për dhjetë vjet përmbushjen e masave të kontrollit, të sqaruara në nenet 2A deri 2E.

2. Megjithatë, çdo palë, që vepron nën paragrafin 1 të këtij neni nuk do të kalojë as nivelin vjetor të llogaritur të konsumit të substancave të kontrolluara në aneksin A prej 0.3 kilogramë për frymë dhe as nivelin vjetor të llogaritur të konsumit të substancave të kontrolluara të aneksit B prej 0.2 kilogramë për frymë.

3. Kur të zbatohen masat e kontrollit të dhëna në nenet 2A deri 2E, çdo palë që vepron nën paragrafin 1 të këtij neni do të jetë e lejuar të përdorë:

a) Për substancat e kontrolluara sipas aneksit A, ose mesataren e nivelit të konsumit vjetor të llogaritur për periudhën 1995 deri në përfshi 1997 ose nivelin e llogaritur të konsumit prej 0.3 kilogramë për frymë, cilido të jetë më i ulët, si bazë për të vendosur përputhjen me masat e kontrollit;

b) Për substancat e kontrolluara sipas aneksit B, mesataren e nivelit të konsumit të llogaritur vjetor për periudhën 1998 deri në përfshi 2000 ose një nivel të llogaritur të konsumit prej 0.2 kilogramësh për frymë, cilido të jetë më i ulët, si bazë për të vendosur përputhjen me masat e kontrollit.

4. Në qoftë se një palë që vepron nën paragrafin 1 të këtij neni, në çdo kohë para se detyrimet e masave të kontrollit në nenet 2A deri 2E, bëhen të aplikueshme për të, e gjen veten të paafte të sigurojë një furnizim adekuat me substanca të kontrolluara, mundet që pala të njoftojë sekretariatin. Sekretariati do t’u drejtojë një kopje të këtij njoftimi palëve, të cilat do ta konsiderojnë çështjen në takimin e radhës, dhe do të vendosin për masat e përshtatshme që duhen marrë.

5. Zhvillimi i kapaciteteve për të përmbushur obligimet e palëve nën paragrafin 1 të këtij neni, në përputhje me masat e kontrollit të dhëna në nenet 2A deri 2E dhe zbatimin e tyre nga po ato palë do të varet nga zbatimi i efektshëm i bashkëpunimit financiar të dhënë nga neni 10 dhe transferimi i teknologjisë siç jepet nga neni 10 A.

6. Çdo palë që vepron nën paragrafin 1 të këtij neni, mundet, në çdo kohë, të njoftojë sekretariatin me shkrim se, mbasi ka ndërmarrë të tërë hapat praktike nuk është në gjendje të zbatojë ndonjë ose të gjitha detyrimet e dhëna në nenet 10 dhe 10A. Sekretariati do t’u transmetojë një kopje të njoftimit palëve, të cilat do ta konsiderojnë çështjen në mbledhjen e radhës, duke i kushtuar vëmendjen e duhur paragrafit 5 të këtij neni dhe do të vendosin për masat e përshtatshme që duhen marrë.

7. Gjatë periudhës ndërmjet njoftimit dhe mbledhjes të palëve në të cilin masat e përshtatshme të referuara në paragrafin 6 më sipër do të vendosen, ose për një periudhë më të gjatë nëse vendoset kështu nga mbledhja e palëve, procedurat e mospërmbushjes të referuara në nenin 8 nuk do të zbatohen kundrejt palës njoftuese.

8. Një mbledhje e palëve do të rishikojë, jo më vonë se viti 1995, situatën e palëve që veprojnë nën paragrafin 1 të këtij neni, duke përfshirë zbatimin efektiv të bashkëpunimit financiar dhe transferimin e teknologjisë në to dhe adoptojë rishikime të tilla që mund të shihen të arsyeshme duke marrë parasysh axhendën e masave të kontrollit që janë të aplikueshme për ato palë.

9. Vendimet e palëve të referuara në paragrafët 4, 6 dhe 7 të këtij neni do të merren sipas të

njëjtës procedurë të aplikuar për vendimmarrje sipas nenit 10.

Q. Neni 6: Vlerësimi dhe rishikimi i masave të kontrollit.

Fjalët e mëposhtme do të shtohet pas “Neni 2” në nenin 6 të protokollit:

Nenet 2A deri 2E, dhe situatat që kanë të bëjnë me prodhimin, importin dhe eksportin e substancave transitore në grupin I të aneksit C.

R. Neni 7: Të dhënat e raportimit

1. Neni 7 i protokollit do të zëvendësohet me të mëposhtmin:

1. Çdo palë do të verë në dispozicion të sekretariatit, brenda tre muajve nga bërja palë, të dhëna statistikore për prodhimin, importimin, eksportimin e secilës nga substancat në aneksin A për vitin 1986 ose të dhënat më të mira të përafërta në rastet kur të dhëna të tilla nuk ekzistojnë.

2. Çdo palë do të verë në dispozicion të sekretariatit të dhëna statistikore për prodhimin, importin dhe eksportin e çdo substance të kontrolluar në grupin B dhe të çdo substance transitore në grupin I të aneksit C, për vitin 1989, ose të dhënat më të mira të përafërta që ekzistojnë jo më vonë se tre muaj nga data kur këto dispozita të dhëna në protokoll përse i përket substancave në aneksin B kanë hyrë në fuqi.

3. Çdo palë do t’i verë sekretariatit në dispozicion të dhëna statistikore për prodhimin e saj vjetor (si është sqaruar në paragrafin 5 të nenit 1) dhe, në mënyrë të veçantë:

- sasitë e përdorura për ushqim për kafshët,
- sasitë e shkatërruara nga teknologjitë e aprovuara nga palët,
- importet dhe eksportet në palët dhe jo palët respektivisht,

të secilës nga substancat e kontrolluara të listuara në aneksin A dhe B, si dhe substancat tradicionale në grupin I të aneksit C, për vitin gjatë të cilit kanë hyrë në fuqi dispozitat që kanë të bëjnë me substancat në aneksin B dhe për çdo vit të mëpasëm. Të dhënat do të dërgohen jo më vonë se nëntë muaj pas mbarimit të vitit të cilit i takojnë të dhënat.

4. Për palët që veprojnë nën dispozitat e paragrafit 8 (a) të nenit 2, kërkesat në paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni përse u përket të dhënave statistikore për importet dhe eksportet do të jenë të mjaftueshme, nëse organizata për integrim ekonomik e interesuar jep të dhëna mbi importet dhe eksportet ndërmjet organizatës dhe shteteve që nuk janë anëtare të asaj organizate.

S. Neni 9: Kërkimi, zhvillimi, ndërgjegjësimi i publikut dhe shkëmbimi i informacionit

Paragrafi 1 (a) i nenit 9 të protokollit do të zëvendësohet me paragrafin e mëposhtëm:

a) Teknologjitë më të mira për të përmirësuar ndalimin, rikuperimin, riciklimin ose shkatërrimin e substancave të kontrolluara dhe atyre transitore ose që zvogëlojnë shkarkimet e tyre;

T. Neni 10: Mekanizmi financiar

Neni 10 i protokollit do të zëvendësohet si më poshtë:

Neni 10: Mekanizmi financiar

1. Palët do të caktojnë një mekanizëm për qëllimet e arritjes së bashkëpunimit financiar dhe teknik, ku përfshihet transferimi i teknologjisë, në palët që veprojnë nën paragrafin 1 të nenit 5 të këtij protokollit për të bërë të mundur përputhjen e tyre me masat e kontrollit të caktuara në nenet 2A deri 2E të këtij protokollit. Mekanizmi, kontributet ndaj të cilit do të jenë shtesë e transfertave të tjera kostot shtesë të palëve në mënyrë që të sigurojë përputhjen e tyre me masat e kontrollit të protokollit. Një listë treguese e kostove të shtuara do të vendoset nga takimi i palëve.

2. Mekanizmi i vendosur nën paragrafin 1 do të përfshijë një fond shumëpalësh. Do të përfshijë gjithashtu mjete të tjera për bashkëpunimin shumëpalësh, rajonal dhe dypalësh.

3. Fondi shumëpalësh:

a) Do të takohet, për një grant ose mbi baza koncensionale si të jetë e përshtatshme, dhe sipas kriterëve që do të vendosen nga palët, kostot e shtuara të rëna dakord;

b) Do të financojë funksionet e clearinghouse;

i) Ndihmojë palët që veprojnë në paragrafin 1 të nenit 5, nëpërmjet studimeve specifike për

vendet dhe bashkëpunim teknik, për të identifikuar nevojat e tyre për bashkëpunim;
ii) Lehtësojë bashkëpunimin teknik për të përmbushur këto nevoja të identifikuar;
iii) Shpërndajë, siç është dhënë në nenin 9, informacion dhe materiale, të bëjë seminare, sesione trajnimi dhe aktivitete të tjera si këto, për përfitim të palëve që janë vende në zhvillim;
iv) Lehtësojë dhe monitorojë bashkëpunimet e tjera rajonale dhe bilaterale të palëve që janë vende në zhvillim;

c) Do të financojë shërbimet sekretariale të fondit shumëpalësh dhe shpenzimet mbështetëse.

4. Fondi shumëpalësh do të veprojë nën autoritetin e palëve, të cilat do të vendosin për politikën e tij të përgjithshme.

5. Palët do të caktojnë një komitet ekzekutiv për të zhvilluar dhe monitoruar zbatimin e politikave vepruese specifike, rregullimet administrative, ku të përfshihen disbursimi i resurseve, për qëllimin e arritjes së objektivave të fondit shumëpalësh. Komiteti ekzekutiv do të heqë detyrat dhe përgjegjësitë e specifikuar në termat e referencës siç është rënë dakord nga palët, me bashkëpunimin dhe ndihmën e Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka Botërore), PNUD, Programi i Kombeve të Bashkuara për mjedisin ose agjenci të tjera në varësi të ekspertizës që ato kanë. Anëtarët e komitetit ekzekutiv që do të përzgjidhen, në bazë të një përfaqësimi të balancuar të palëve që veprojnë nën paragrafin 1 të nenit 5 dhe të palëve që nuk veprojnë sipas nën këtë paragraf, do të autorizohet nga palët.

6. Fondi shumëpalësh do të financohet nga kontributet prej palëve që nuk operojnë nën paragrafin 1 të nenit 5 në monedhë të konvertueshme ose situatë të veçantë, në natyrë dhe/ose monedhën vendase, mbi bazën e shkallës së vlerësimit të Kombeve të Bashkuara. Kontributet nga palët e tjera do të inkurajohen. Bashkëpunimi bilateral dhe, në raste të veçanta kur bihet dakord me një vendim të palëve, bashkëpunimi rajonal mund, deri në një përqindje dhe me çdo kriter që do të specifikohet nga palët, do të konsiderohet si kontribut për fondin shumëpalësh, duke pasur parasysh që ky bashkëpunim, në minimum:

a) Lidhet strikt dhe përputhet me dispozitat e këtij protokollit;

b) Sigurohen resurse shtesë;

c) Pranon kostot e shtuara të rëna dakord.

7. Palët do të vendosin për buxhetin e programit të fondit shumëpalësh për çdo periudhë fiskale dhe sipas përqindjes së kontributeve të secilës palë.

8. Resurset nën fondin shumëpalësh do të shpërndahen me marrëveshjen e palëve përfituese.

9. Vendimet nga palët nën këtë nen do të merren me konsensus kurdo të jetë e mundur. Në qoftë se të gjitha përpjekjet për konsensus janë mbaruar dhe nuk kanë konkluduar në marrëveshje, vendimet do të adoptohen me një votë dy të tretat maxhoritare të palëve që janë të pranishme dhe votojnë, kur palët që janë prezent dhe votojnë, si dhe shumica e palëve që nuk veprojnë nën këtë paragraf që janë të pranishme dhe votojnë.

10. Mekanizmi financiar i caktuar në këtë nen nuk ka paragjykime për rregullime në të ardhmen që mund të zhvillohen duke pasur parasysh çështje të tjera mjedisore.

U. Neni 10A: Transferimi i teknologjisë

Neni i mëposhtëm do t'i shtohet protokollit si neni 10A:

Neni 10A: Transferimi i teknologjisë

Çdo palë do të ndërmarrë çdo hap praktik, në përputhje me programet mbështetur nga mekanizmi financiar, për të siguruar:

a) që teknologjia më e mirë e mundshme, e sigurt nga pikëpamja mjedisore dhe teknologji të tjera të lidhura me të të transferohen shpejt brenda palëve që operojnë nën paragrafin 1 të nenit 5;

b) që transfertat e referuara në nënparagrafin (a) bëhen sipas kushteve të ndershme dhe favorizuese.

V. Neni 11: Takimet e palëve

Paragrafi 4 (g) i nenit 11 të protokollit do të zëvendësohet me paragrafin e mëposhtëm:

g) Vlerësojë, në përputhje me nenin 6, masat e kontrollit dhe situatën përsa i përket substancave transitore;

W. Neni 17: Palët që shtohen pas hyrjes në fuqi
Fjalët e mëposhtme do të shtohen pas (si dhe nën) në nenin 17:
Nenet 2A deri 2E, dhe

X. Neni 19: Tërheqja

Neni 19 i protokollit do të zëvendësohet me paragrafin e mëposhtëm:

Çdo palë mund të tërhiqet nga ky protokoll duke i bërë një njoftim me shkrim Depozitarit në çdo kohë pas katër viteve të përmbushjes së detyrimeve të specifikuara në paragrafin 1 të nenit 2A. Çdo tërheqje e tillë do të bëhet efektive pas mbarimit të kohës prej një viti nga data e marrjes nga Depozitari ose në një datë të movonshme siç mund të jetë e specifikuar në njoftimin e tërheqjes.

Y. Anekset

Anekset e mëposhtme do t'i shtohen protokollit:

Aneksi B

Substancat e kontrolluara

Grupe substancash ozon holluese potenciale

Grupi I

CF3C1 (CFC13) 1.0

C2FC15 (CFC111) 1.0

C2F2C14 (CFC112) 1.0

C3FC17 (CFC211) 1.0

C3F2C16 (CFC212) 1.0

C3F3C15 (CFC213) 1.0

C3F4C14 (CFC214) 1.0

C3F5C13 (CFC215) 1.0

C3F6C12 (CFC216) 1.0

C3F7C1 (CFC217) 1.0

Grupi II

CC14 karbon tetraklorid 1.1

Grupi III

C2H3C13* 1,1,1 trikloretan 0.1

(metil kloroform)

* kjo formulë nuk i referohet 1,1,2 trikloretanit.

Aneksi C

Substancat transitore

Grupi i substancave

Grupi I

CHFC12 (HCFC 21)

CHF2C1 (HCFC 22)

CH2FC1 (HCFC 31)

C2HFC14 (HCFC 121)

C2HF2C13 (HCFC 122)

C2HF3C12 (HCFC 123)

C2HF4C1 (HCFC 124)

C2H2FC13 (HCFC 131)

CH2F2C12 (HCFC 132)

C2H2F3C1 (HCFC 133)

C2H3FC12 (HCFC 141)
C2H3F2C1 (HCFC 142)
C2H4FC1 (HCFC 151)
C3HFC16 (HCFC 221)
C3HF2C15 (HCFC 222)
C3HF3C14 (HCFC 223)
C3HF4C13 (HCFC 224)
C3HF5C12 (HCFC 225)
C3HF6C1 (HCFC 226)
C3H2FC15 (HCFC 231)
C3H2F2C14 (HCFC 232)
C3H2F3C13 (HCFC 233)
C3H2F4C12 (HCFC 234)
C3H2F5C1 (HCFC 235)
C3H3FC14 (HCFC 241)
C3H3F2C13 (HCFC 242)
C3H3F3C12 (HCFC 243)
C3H3F4C1 (HCFC 244)
C3H4FC13 (HCFC 251)
C3H4F2C12 (HCFC 252)
C3H4F3C1 (HCFC 253)
C3H5FC12 (HCFC 261)
C3H5F2C1 (HCFC 262)
C3H6FC1 (HCFC 271)

Neni 2 Hyrja në fuqi

1. Ky amendament do të hyjë në fuqi në 1 janar 1992, në rast se të paktën njëzet instrumente ratifikimi, pranimi ose miratimi për amendamentin janë depozituar nga shtetet ose organizatat rajonale për integrim ekonomik që janë palë të protokollit të Montrealit për substancat që hollojnë shtresën e ozonit.

Në rast se ky kusht nuk është përmbushur deri në atë datë, amendamenti do të hyjë në fuqi në ditën e nëntëdhjetë pas ditës që të jetë përmbushur.

2. Për qëllimet e paragrafit 1, çdo instrument i tillë i depozituar nga një organizatë e integritit ekonomik rajonal nuk do të konsiderohet si shtesë e atyre të depozituara nga vendet anëtare të një organizate të tillë.

3. Pas hyrjes në fuqi të këtij amendamenti siç është dhënë në paragrafin 1, amendamenti hyn në fuqi për çdo palë tjetër të këtij protokollit në ditën e nëntëdhjetë pas datës së depozitimit të instrumentitratifikimit, pranimit ose miratimit.

L I G J Nr.9485, datë 6.3.2006

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË AMENDAMENTIN E MONTREALIT TË PROTOKOLLIT TË MONTREALIT “PËR SUBSTANCAT QË HOLLOJNË SHTRRESËN E OZONIT”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në amendamentin e Montrealit të Protokollit të Montrealit “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekreten nr.4808, datë 20.3.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Alfred Moisiu**

**AMENDAMENT I PROTOKOLLIT
TË MONTREALIT PËR SUBSTANCAT QË HOLLOJNË SHTRESËN E OZONIT,
MIRATUAR NGA TAKIMI I NËNTË I PALËVE**

Neni 1

Amendamenti

A. Neni 4, paragrafi 1 qua

Paragrafi i mëposhtëm do të futet pas paragrafit 1 ter të nenit 4 të protokollit:

1 qua. Brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij paragrafi, çdo palë do të ndalojë importin e substancës së kontrolluar në aneksin E nga shtete që nuk janë palë të këtij protokolli.

B. Neni 4, paragrafi 2 qua

Paragrafi i mëposhtëm do të futet pas paragrafit 2 ter të nenit 4 të protokollit:

2 qua. Duke filluar nga një vit pas datës së hyrjes në fuqi të këtij paragrafi, çdo palë do të ndalojë eksportin e substancës së kontrolluar në aneksin E në çdo shtet që nuk është palë e këtij protokolli.

C. Neni 4, paragrafët 5, 6 dhe 7

Në paragrafët 5, 6 dhe 7 të nenit 4 të protokollit, për fjalët:

Dhe grupi II i aneksit C

Atje do të zëvendësohen:

Grupi II të aneksit C dhe aneksin E

D. Neni 4, paragrafi 8

Në paragrafin 8 të nenit 4 të protokollit, për fjalët:

Neni 2G

Do të zëvendësohen me:

Nenet 2G dhe 2H

E. Neni 4A: Kontrolli i tregtisë me palët

Neni i mëposhtëm do t'i shtohet protokollit si neni 4A:

1. Në rastet kur pas kalimit të datës së aplikueshme për një substancë të kontrolluar, një palë është në gjendje, megjithëse ka marrë të gjitha hapat praktike për të përmbushur detyrimet e protokollit, të ndalojë prodhimin e kësaj substance për konsum vendas, me përjashtim të përdorimeve të tjera të rëna dakord nga palët që janë thelbësore, ajo do të ndalojë eksportin e sasive të përdorura, ricikluara dhe rikuperuara të kësaj substance, për qëllime të tjera përveç shkatërrimit.

2. Paragrafi 1 i këtij neni do të aplikohet pa paragjykim për veprimin e nenit 11 të Konventës dhe procedurat e moszbatimit zhvilluar nën nenin 8 të këtij protokollit.

F. Neni 4B: Licencimi

Neni i mëposhtëm do t'i shtohet protokollit si neni 4B:

1. Çdo Palë, që nga 1 janari 2000 ose brenda tre muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij neni, cilado nga këto data që është e mëvonshme, do të vendosë dhe do të zbatojë një sistem për licencimin e importit dhe eksportit të substancave të reja, ricikluara ose rikuperuara në anekset A, B, C dhe E.

2. Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, çdo palë që vepron nën paragrafin 1 të nenit 5, e cila vendos që nuk është në gjendje të vendosë dhe të zbatojë një sistem për licencimin e importit dhe eksportit të substancave të kontrolluara në anekset C dhe E, mund ta shtyjë marrjen e këtyre vendimeve, respektivisht, deri në 1 janar 2005 dhe 1 janar 2002.

3. Çdo palë, brenda tre muajve nga data e futjes së sistemit të licencimit, do t'i raportojë sekretariatit mbi vendosjen e këtij sistemi.

4. Sekretariati, periodikisht, do të përgatisë dhe do të qarkullojë në të gjitha palët, një listë të të gjitha palëve që kanë raportuar për sistemin e licencimit dhe do t'ia kalojë këtë informacion Komitetit të Implementimit për vlerësim dhe rekomandime për palët.

Neni 2

Lidhja me amendamentin e vitit 1992

Asnjë shtet ose organizatë për integrim ekonomik rajonal nuk mund të depozitojë një instrument ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi me këtë amendament në rast se, më parë ose në të njëjtën kohë, nuk ka depozituar një instrument të tillë për amendamentin e miratuar në takimin e katërt të palëve në Kopenhagen më 25 nëntor 1992.

Neni 3

Hyrja në fuqi

1. Ky amendament do të hyjë në fuqi më 1 janar 1999, në rast se të paktën njëzet instrumente ratifikimi, pranimi ose miratimi të këtij amendamenti janë depozituar nga shtetet ose organizatat ekonomike për integrim rajonal që janë palë të protokollit të Montrealit për substancat që hollojnë shtresën e ozonit. Në rast se ky kusht nuk është përmbushur deri në atë datë, amendamenti do të hyjë në fuqi në ditën e nëntëdhjetë pas datës në të cilën është plotësuar.

2. Për qëllime të paragrafit 1, çdo instrument i tillë i depozituar nga një organizatë rajonale për integrim ekonomik nuk do të konsiderohet si shtesë e atyre të depozituara nga shtetet anëtare të këtyre organizatave.

3. Pas hyrjes në fuqi të këtij amendamenti, siç jepet në paragrafin 1, ai hyn në fuqi për të gjitha palët e tjera të protokollit në ditën e nëntëdhjetë të depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimi ose miratimit.

L I G J

Nr.9486, datë 6.3.2006

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË AMENDAMENTIN E PEKINIT TË
PROTOKOLLIT TË MONTREALIT "PËR SUBSTANCAT QË HOLLOJNË
SHTRESËN E OZONIT"**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në amendamentin e Pekinit të Protokollit të Montrealit “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.4809, datë 20.3.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu

AMENDAMENTI I PEKINIT

(Marrë nga aneksi V i raportit të mbledhjes së njëmbëdhjetë të palëve të protokollit të Montrealit për substancat që dëmtojnë shtresën e ozonit)

ANEKSI V AMENDAMENT I PROTOKOLLIT TË MONTREALIT PËR SUBSTANCAT OZONHOLLUESE

Neni 1

Amendim

A. Neni 2, paragrafi 5

Në paragrafin 5 të nenit 2 të protokollit, fjalët:

Nenet 2A deri 2E do të zëvendësohen me nenet 2A deri 2F;

B. Neni 2, paragrafët 8 (a) dhe 11

Në paragrafët 8 (a) dhe 11 të nenit 2 të protokollit, fjalët:

Nenet 2A deri 2H do të zëvendësohen me nenet 2A deri 2I;

C. Neni 2F, paragrafi 8

Paragrafi i mëposhtëm do të shtohet pas paragrafit 7 të nenit 2F të protokollit:

Çdo palë prodhuese e një ose më shumë prej këtyre substancave do të sigurojë që, për një periudhë dymbëdhjetëmujore duke filluar nga 1 janari 2004 dhe në çdo periudhë 12-mujore të mëpasme, niveli i përlogaritur i prodhimit të substancave të kontrolluara në grupin I të aneksit C nuk e kalon, në vit, mesataren e:

a) shumës së nivelit të përlogaritur të konsumit në 1989 të substancave të kontrolluara në grupin I të aneksit C dhe dy pikë tetë për qind të nivelit të kalkuluar në vitin 1989 të substancave të kontrolluara në grupin e I-rë të aneksit A; dhe

b) shumës së nivelit të kalkuluar të prodhimit në vitin 1989 të prodhimit të substancave të kontrolluara në grupin I të aneksit C dhe dy pikë tetë për qind të nivelit të përlogaritur të prodhimit në vitin 1989 të substancave të kontrolluara në grupin I të aneksit A.

Megjithatë, në mënyrë që të plotësohen kërkesat bazë vendore të palëve që operojnë sipas paragrafit 1 të nenit 5, niveli i përlogaritur i prodhimit mund të kalojë këtë limit deri në pesëmbëdhjetë për qind të nivelit të përlogaritur të prodhimit të substancave të kontrolluara në grupin

I të aneksit C siç janë dhënë më sipër:

D. Neni 2I

Neni i mëposhtëm do të futet pas nenit 2H të protokollit:

Neni 2I: Bromochlorometani

Çdo palë do të sigurojë që për një periudhë kohe dymbëdhjetëmuajore, duke filluar nga 1 janari 2002, dhe në çdo periudhë dymbëdhjetëmuajore pasuese, niveli i përlllogaritur i konsumit dhe i prodhimit të substancës në grupin e III-të, të aneksit C nuk e kalon zeron. Ky paragraf do të zbatohet përveç rasteve kur palët vendosin të lejojnë nivelin e prodhimit ose të konsumit që është i nevojshëm të plotësojë përdorimet për të cilat është rënë dakord që janë esenciale.

E. Neni 3

Në nenin 3 të protokollit, fjalët:

Nenet 2, 2A deri 2H do të zëvendësohen me nenet 2, 2A deri 2I.

F. Neni 4, paragrafët 1 quin dhe 1 sex

Paragrafët e mëposhtëm do të shtohen në nenin 4 të protokollit pas paragrafit 1 qua:

1 quin. Që nga 1 janari 2004, çdo palë do të ndalojë importin e substancave të kontrolluara në grupin I të aneksit C nga çdo shtet që nuk është palë e këtij protokollit.

1 sex. Brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij paragrafi, çdo palë do të ndalojë importin e substancave të kontrolluara në grupin III të aneksit C nga çdo shtet që nuk është palë e këtij protokollit.

G. Neni 4, paragrafët 2 quin dhe 2 sex

Paragrafët e mëposhtëm do të shtohen në nenin 4 të protokollit pas paragrafit 2 qua:

2 quin. Që nga 1 janari 2004, çdo palë do të ndalojë eksportin e substancave të kontrolluara në grupin I të aneksit C në çdo shtet që nuk është palë e këtij protokollit.

2 sex. Brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij paragrafi, çdo palë duhet të ndalojë eksportin e substancave të kontrolluara në grupin III të aneksit C në çdo shtet jopalë të këtij protokollit.

H. Neni 4, paragrafët 5 deri 7

Në paragrafët 5 deri 7 të nenit 4 të protokollit, për fjalët:

Anekset A dhe B, grupi II të aneksit C dhe aneksit E do të zëvendësohen me aneksin A, B, C dhe E.

I. Neni 4, paragrafi 8

Në paragrafin 8 të nenit 4 të protokollit, fjalët:

Nenet 2A deri 2E, nenet 2G dhe 2H të zëvendësohen me nenet 2A deri 2I;

J. Neni 5, paragrafi 4

Në paragrafin 4 të nenit 5 të protokollit, fjalët:

Nenet 2A deri 2H do të zëvendësohen me nenet 2A deri 2I;

K. Neni 5, paragrafët 5 dhe 6

Në paragrafin 5 dhe 6 të nenit 5 të protokollit, fjalët:

Nenet 2A deri 2E do të zëvendësohen me nenet 2A deri 2E dhe neni 2I;

L. Neni 5, paragrafi 8 ter (a)

Fjalja e mëposhtme do të shtohet në fund të paragrafit 8 ter (a) të nenit 5 të protokollit:

Që nga 1 janari 2016, çdo palë që vepron nën paragrafët 1 të këtij neni do të zbatojë masat e kontrollit të dhëna në paragrafin 8 të nenit 2F, dhe si bazë për përmbushjen e këtyre masave të kontrollit, do të përdorë mesataren e nivelit të përlllogaritur të prodhimit dhe konsumit në vitin 2015;

M. Neni 6

Në nenin 6 të protokollit, fjalët:

Nenet 2A deri 2H do të zëvendësohen me nenet 2A deri 2I;

N. Neni 7, paragrafi 2

Në paragrafin 2 të nenit 7 të protokollit, fjalët:

Aneksat B dhe C do të zëvendësohen me aneksat B dhe grupet I dhe II të aneksit C.

O. Neni 7, paragrafi 3

Fjalja e mëposhtme do të shtohet pas fjalisë së parë të paragrafit 3 të nenit 7 të protokollit:

Çdo palë do t'i dërgojë sekretariatit të dhëna statistikore mbi sasinë vjetore të substancës së kontrolluar të listuar në aneksin E të përdorur për karantinë dhe aplikimet paradërgimore.

P. Neni 10

Në paragrafin 1 të nenit 10 të protokollit, fjalët:

Nenet 2A deri 2E do të zëvendësohen me nenet 2A deri 2E dhe neni 2I.

Q. Neni 17

Në nenin 17 të protokollit, fjalët:

Nenet 2A deri 2H do të zëvendësohen me nenet 2A deri 2I.

R. Aneksi C

Grupi i mëposhtëm do të shtohet në aneksin C të protokollit:

Numri i i grupsubstancave izomere ozonholluese potenciale

Potential (Potenciale) grupi III CH₂BrCI bromoklorometan 10.12.

Neni 2

Marrëdhënia me amendamentin e vitit 1997

Asnjë shtet ose organizatë për integrimin rajonal ekonomik nuk mund të depozitojë ndonjë instrument ratifikimi, pranimi ose aprovimi ose rënie dakord për këtë amendament në rast se nuk ka depozituar më parë ose në të njëjtën kohë një instrument të tillë në amendimin e adoptuar në takimin e nëntë të palëve në Montreal, 17 shtator 1997.

Neni 3

Hyrja në fuqi

1. Ky amendament do të hyjë në fuqi më 1 janar 2001, në rast se të paktën njëzet instrumente ratifikimi, pranimi ose aprovimi janë depozituar nga shtetet ose organizatat për integrim ekonomik rajonal që janë palë të protokollit të Montrealit për substancat që dobësojnë shtresën e ozonit. Në rast se ky kusht nuk është plotësuar deri në atë datë, amendamenti do të hyjë në fuqi në ditën e nëntëdhjetë nga data në të cilën është plotësuar.

2. Për qëllimet e paragrafit 1, çdo instrument i tillë i depozituar nga organizatat ekonomike për integrim rajonal nuk do të merret si shtesë e atyre të depozituara nga shtetet anëtare të këtyre organizatave.

3. Pas hyrjes në fuqi të këtij amendamenti, siç është dhënë në paragrafin 1, ai do të hyjë në fuqi për çdo palë tjetër të protokollit në ditën e nëntëdhjetë pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit ose aprovimit.

VENDIM

Nr.23, datë 13.3.2006

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.88, DATË 8.9.2003 "PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE TË INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE

KONTROLLIT TË PASURIVE”, NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR.189, DATË 19.5.2005 TË KUVENDIT

Në mbështetje të nenit 16 pika 4 të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të neneve 41, pika 1, e 42 të ligjit nr.9367, datë 10.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, ndryshuar me ligjin nr.9475, datë 9.2.2006, si dhe nenit 88 të Rregullores së Kuvendit,

**K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Në vendimin nr.88, datë 8.9.2003, ndryshuar me vendimin nr.189, datë 19.5.2005 të Kuvendit, bëhet ndryshimi si më poshtë:

Në pikën 1 fjalët “prej 35 vetësh” zëvendësohen me fjalët “prej 41 vetësh”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)**

**DEKRET
Nr.4810, datë 21.3.2006**

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15,19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|------------------------------------|--|
| 1.Mimoza Nikolla Marku | 24.Klind Emond Resmi |
| 2.Sherife Hamit Kröger (Koçi) | 25.Genci Tahir Alstafa |
| 3.Andi Kastriot Binaj | 26.Gerolda Genci Alstafa |
| 4.Shpresa Baku Kodra | 27.Rozafa Selman Alstafa (Lika) |
| 5.Shpresa Gani Gazheli | 28.Fatmir Shaban Mehmeti |
| 6.Mustafa Xhemal Turku | 29.Jennifer Famir Mehmeti |
| 7.Vjollca Myfit Turku (Mustabelli) | 30.Nazime Rushit Mehmeti (Beqiri) |
| 8.Eduard Ferdinand Cipo | 31.Alban Fatmir Mehmeti |
| 9.Klodian Luan Koçi | 32.Tatjana Ismail Sheko |
| 10.Ervin Vilhelm Karalliu | 33.Frida Pullumb Barçi-Kajtazi (Barçi) |
| 11.Elton Zenel Çaçi | 34.Luiza Ndue Aga (Stojani) |
| 12.Aurela Bajram Gosturani (Toska) | 35.Marvin Shkëlqim Aga |
| 13.Valbona Muharrem Zaimi | 36.Gazmir Halil Zikaj |
| 14.Marsel Agim Llabani | 37.Edlira Haziz Bega (Selba) |
| 15.Entela Tasi Qafëzezi | 38.Dashmir Sulejman Meta |
| 16.Jani Theodhor Kolezi | 39.Altin Gani Dervina |

17.Margarita Franc Kolezi (Ivanaj)
18.Juxhin Beqir Kolloshina
19.Rudina Ali Turku (Meta)
20.Klajdi Shefqet Duravaku
21.Arjan Zyber Ndreu van Damme
22.Gëzim Neshat Fetishi
23.Mimoza Mahmut Resmi (Terziu)

40.Romeo Vasil Miho
41.Bashkim Mustafa Gjinushi
42.Marcel Sebastian Bashkim Gjinushi
43.Elona Ylli Gromoll (Doce)
44.Sokol Hilmi Petrela
45.Majlinda Sulçe Hußman (Xhufi)
46.Denise Christel Fatmir Peza

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

DEKRET
Nr.4811, datë 21.3.2006

PËR LIRIM AMBASADORI

Në mbështetje të nenit 92 pika “dh” të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Pavli Zëri lirohet nga detyra e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Republikën Italiane.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e rrethit gjyqësor Kavajë me vendimin nr.93, datë 21.2.2006 vendosi të shpallë të zhdukur shtetasin Demir Biduli.

KËRKESË

Shtetasi Enver Zyberaj banues në Tiranë, kërkon shpalljen të zhdukur të shtetaseve Laje Zyberaj dhe Flutura Zyberaj.

KËRKUESE
Enver Zyberaj

Ndreqje gabimi

1. Në Fletoren nr.9 të datës 15 shkurt 2006, titulli i urdhrit të ILDKP

është:

Për një ndryshim në urdhrin nr.6, datë 25.11.2004 të Inspektorit “Për miratimin e llojeve të deklaratës së interesave private dhe autorizimit përkatës”

bëhet:

Për një ndryshim në urdhrin nr.16, datë 25.11.2004 të Inspektorit “Për miratimin e llojeve të deklaratës së interesave private dhe autorizimit përkatës”

2. Në kapakun e Fletores nr.15 të datës 2 mars 2006, data e ligjit nr.9452

është: 2.2.2005

bëhet: 2.2.2006

Abonimet vjetore mund te bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendres së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi Zhan d'Ark, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel. 042 555 63; ose 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK	1500
(2006).....	
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
.....	
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)	1500
4. PËR TAKSAT DHE TATIMET...(+ suplement 2006).....	1500
1. TREGUESI KRONOLOGJIK I	1500
LEGJISLACIONIT.....	
2. TREGUESI TEMATIK I	2000
LEGJISLACIONIT.....	

Botime të reja

1. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500
2. KODI	1000
DOGANOR.....	
3. KODI DETAR	1000
.....	

U dorëzua për shtyp më 30.3.2006
Doli nga shtypi më 6.4.2006

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2006

Çmimi 150 lekë